



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ARTEVE
REKTORATI
ADMINISTRATOR

URDHËR

NR 55, DATË 13/11/2020

MBI

“FILLIMIN E PROCEDURËS SË PRANIMIT DHE SHQYRTIMIT TË DOKUMENTACIONIT, NGA ANA E FAKULTETEVE TË UNIVERSITETIT TË ARTEVE, PËR STUDENTËT, TË CILËT DO TË APLIKOJNË PËR PËRFITIMIN E BURSIVE NGA FONDI I MBËSHTETJES STUDENTORE, PËR STUDENTËT E SHKËLQYER, STUDENTËT QË STUDIOJNË NË PROGRAME STUDIMI NË FUSHAT PRIORITARE DHE STUDENTËT NË NEVOJË”, PËR VITIN AKADEMIK 2020-2021 NË UART”

Në zbatim të nenit 112 të ligjit Nr.80/2015, datë 22.07.2015 për “Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” të neneve 1 dhe 5 të ligjit Nr 10289, datë 17.06.2010 për “Mënyrën e trajtimit ekonomik dhe financiar dhe për dhënie ndihme të menjëhershme familjeve të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ Shtetëror dhe të Policisë së Burgjeve që humbin jetën në krye apo për shkak të detyrës”; të nenit 2 të ligjit Nr. 7889 datë 14.12.1994 për “Statusin e invalidëve të punës”(i ndryshuar), VKM Nr.869, datë 18.06.2008 “Për zbatimin e ligjit Nr.7889 datë 14.12.1994 për Statusin e invalidëve të punës” i ndryshuar; nenit 6 të ligjit Nr.8153, datë 31.10.1996 për “Statusin e jetimit (i ndryshuar)” nenit 8 të ligjit Nr.8098 datë 28.03.1996 për “Statusin e të verbërit (i ndryshuar)”; nenit 8 të ligjit Nr.8626 datë 22.06.2000 për “Statusin e invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik” (i ndryshuar); nenit 12 të ligjit Nr.7748, datë 29.07.1993 për “Statusin e ish të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist” (i ndryshuar);nenit 32 të ligjit Nr.9355 datë 10.03 2005 për “Ndihmën dhe shërbimet shoqërore” (i ndryshuar), të VKM Nr.903, datë 21.12.2016 për “Përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave nga fondi i mbështetjes studentore për studentët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në programe studimi në fushat prioritare dhe studentët në nevojë” (i ndryshuar), të VKM Nr.39, datë 23.01.2019 “Për disa ndryshime në VKM Nr.903 datë 21.12.2016”,

URDHËROJ

1. Ngritjen e grupit të punës në fakultetet e Universitetit të Arteve për pranimin dhe shqyrtimin e aplikimeve të studentëve që do të përfitojnë bursë për vitin akademik 2020-2021;





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

2. Punonjësit që do të merren me administrimin e procesit në cdo fakultet, do të jenë si më poshtë:
 - Nermin Zebi (Fakulteti i Muzikës), nermin_zebi@yahoo.com;
 - Arta Dashi (Fakulteti i Arteve të Bukura), arta_dash@yahoo.com;
 - Enela Mastori (Fakulteti i Artit Skenik), enelamastori@yahoo.com
3. Studentët duhet të aplikojnë online, duke dorëzuar dokumentacionin sipas formulareve (bashkëlidhur) të skanuara në adresën elektronike të fakultetit përkatës; duke filluar nga data **13/11/2020**.
4. Studentët brenda më datë **4 Dhjetor 2020**, përveç aplikimit online duhet të dorëzojnë fizikisht të gjithë dokumentacionin (të cilin kanë dorëzuar paraprakisht online). Dokumentacioni i dorëzuar fizikisht do të shoqërohet me proces verbal sipas formatit bashkëlidhur firmosur nga studenti dhe përfaqësuesi i Fakultetit përkatës;
5. Grupi i punës në Fakultete ka për detyrë të pranojë dhe shqyrtojë dokumentacionin sipas kriterëve të përcaktuara në VKM Nr. 903, datë 21.12.2016 për “Përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave nga fondi i mbështetjes studentore për studentët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në programe studimi në fushat prioritare dhe studentët në nevojë” (i ndryshuar);
6. Afati përfundimtar për dorëzimin e dokumentacionit, në zyrën e protokollit në Rektorat, nga Grupi i punës është data **11.12.2020**;
7. Grupi i punës mban proces verbalin ku përcaktohen studentët që përfitojnë ose jo bursë për vitin akademik 2020-2021 dhe ja përcjell për verifikim Sektorit Juridik;
8. Pas verifikimit të dokumentacionit të Grupit të punës nga Sektori Juridik, përgatitet Informacioni për Administratoren e Universitetit të Arteve;
9. Afati përfundimtar për mbarimin e punës nga ana e grupit të punës dhe Sekyorit Juridik është data **14/12/2020**;
10. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhëri grupi i punës, Dekanët, Sekretarët në Fakultete, Sektori Juridik, Zyra e protokollit pranë Universitetit të Arteve dhe sektori i IT.
11. Ky urdhër të shpallet në faqen zyrtare të Universitetit të Arteve

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë

Msc. Alma Sinanaj

**ADMINISTRATOR
UNIVERSITETI I ARTEVE**



FORMULAR DEKLARIMI

Unë i/e nënshkruari/a _____, student/e në UART në Fakultetin _____ në vitin e _____ me kartë identiteti _____, e-mail: _____, Cel: _____, aplikoj për përfitim burse dhe/ ose përjashtim nga tarifa vjetore e shkollimit, për vitin akademik 2020-2021, dhe deklaroj si më poshtë:

1. Jam njohur me kriteret dhe parashikimet e akteve nënligjore për përfitim burse dhe/ose përjashtim nga tarifa vjetore e shkollimit dhe i pranoj ato.
2. Autorizoj Universitetin e Arteve në Tiranë për trajtimin e të dhënave të mia personale në kuadër të aplikimit tim si dhe publikimin e tyre.
3. Autorizoj Universitetin e Arteve për kryerjen e të gjitha verifikimeve dhe marrjen e të gjithë informacioneve lidhur me aplikimin, si dhe me të dhënat e deklaruara në këtë formular.
4. Deklaroj vërtetësinë e të dhënave dhe dokumenteve të paraqitura.

Jam i/e vetëdijshëm se, në rast deklarimi të të dhënave të pavërteta apo të paraqitjes së dokumenteve të falsifikuara apo me të dhëna jo të vërteta, jam subjekt i masave të parashikuara në Kodin Penal dhe aktet e tjera ligjore e nënligjore në fuqi.

Dorëzuesi

Marrësi në dorëzim

(Emër Atësi Mbiemër i aplikantit) (Emër Mbiemër i punonjësit që pranoi aplikimin)

Firma

Firma





PROCESVERBAL
PËR DORËZIMIN E DOSJES SË DOKUMENTACIONIT

Dosja ka përmbajtje sipas kësaj liste dokumentacioni:

Nr.	Emërtimi i dokumentit	Origjinale/fotokopje	Nr. flet
1.			
2.			
3.			
4.			
5.			
6.			
7.			
8.			
9.			

MARRËSI NË DORËZIM

DOREZUESI

